



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "AOME shpk" të datës 29.12.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me dru për ngrohjen e objekteve arsimore, AMF-të, bashkësitë lokale dhe nevojat tjera komunale" me nr. të prokurimit 616-25-5474-1-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "AOME shpk" të datës 29.12.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me dru për ngrohjen e objekteve arsimore, AMF-të, bashkësitë lokale dhe nevojat tjera komunale" me nr. të prokurimit 616-25-5474-1-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "AOME shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 29.12.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me dru për ngrohjen e objekteve arsimore, AMF-të, bashkësitë lokale dhe nevojat tjera komunale" me nr. të prokurimit 616-25-5474-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

Me këtë, ju keni vepruar plotësisht në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik, përkatësisht keni vepruar në kundërshtim me trajtimin e çmimit jo-normalisht të ulët sipas nenit 61 të LPP, dhe atë për këto arsye:

- Me kërkesën tuaj ne ju kemi dërguar një shkresë me të gjitha arsyet bindëse lidhur me çmimin tonë të ofruar. Ne ju kemi ofruar të gjitha faturat origjinale të furnizimit së bashku me dëshmitë e transaksioneve bankare, të cilat qëllimisht nuk jan marrë parasyshtë nga ju dhe komisioni i vlerësimit.
- Ne ju kemi shpjeguar se furnizimi me lëndë drusore nuk është projekt kompleks dhe nuk ka ndonjë proces të ndërlikuar të prodhimit, prandaj çmimi i furnizimit duke i shtuar një marzhë të fitimit ju është ofruar juve i cili do të duhet pranuar.
- Ju dhe as Komisioni i vlerësimit nuk na keni ofruar sqarimet e nevojshme pse oferta e jonë nuk është pranuar, perveq deklaratës se komisioni “nuk është bindur” e cila jo vetëm që është e pamjaftueshme por është jo-ligjore dhe madje skandaloze.
- Me një analizë të thjeshtë dhe një hulumtim të tregut, çmimi i druve prej 80 Euro për metër është çmim që e tejkalon dukshëm edhe furnizimin me pakicë e lërë furnizimin me shumicë. Andaj refuzimi i ofertës tonë të përgjegjshme dhe pranimi i një oferte me çmim dyfish më të lartë është jo vetëm keqpërdorim i parasë publike por edhe veprim korruptiv.
- Edhe pse ne kemi kërkuar, ju nuk ka keni ofruar raportin e vlerësimit të komisionit duke mos na dhënë qasje të plotë se pse komisioni nuk është bindur me sqarimet e tona për çmimkn e ofruar, çka përbën fshhje dhe jotransparencë të plotë
- Në zbatim të nenit 61 të LPP, ju nuk e keni njoftuar KRPP-në lidhur me eliminimin tonë sepse gjatë qasjes në dokumente ju nuk na keni ofruar dëshmi se e keni njoftuar KRPP-në.

Sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar për arsyet si në vijim:

ARSYETIM

Ju njoftojmë se oferta juaj është vlerësuar si e papërgjegjshme, për këto arsye:

Juve ju është kërkuar sqarime për çmim Jo normalisht të ulët me datën 21.11.2025, komfort nenit 61 të LPP-së, dhe Nenit 41.3 ose 41.4 të Rregullores P.P.P Nr. 001/2022.

Ju me datën 26.11.2025 keni dërguar sqarimet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar sqarimet e dërguara nga ana juaj dhe ka konstatuar se për pozicionet 1, të kërkesave të Autoritetit Kontraktues për AK-në janë të pa pranueshme, përgjigjet e juaja lidhur me sqarimet e kërkuara nuk janë të argumentuara as bindëse për AK-në.

Në vijim të procedurave të vlerësimit të ofertave për aktivitetin e prokurimit me titull:

“Furnizimi me dru për ngrohjen e objekteve arsimore, AMF- të, bashkësitë lokale dhe nevojat tjera komunale”, komisioni i vlerësimit pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit

të ofertës tuaj nga Komisioni i Vlerësimit, është konstatuar se: oferta juaj është vlerësuar si e papërgjegjshme, për këto arsye:

Ju njoftojmë se oferta juaj është vlerësuar si e papërgjegjshme, për këto arsye:

Juve ju është kërkuar sqarime për çmim Jo normalisht të ulët me datën 21.11.2025, komfort nenit 61 të LPP-së, dhe Nenit 41.3 ose 41.4 të Rregullores P.P.P Nr. 001/2022.

Ju me datën 26.11.2025 keni dërguar sqarimet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar sqarimet e dërguara nga ana juaj dhe ka konstatuar se për pozicionet 1, të kërkesave të Autoritetit Kontraktues për AK-në janë të pa pranueshme, përgjigjet e juaja lidhur me sqarimet e kërkuara nuk janë të argumentuara as bindëse për AK-në.

Në përputhje me vendimin e Zyrës së Prokurimit Publik (ZPP) dhe sqarimet e kërkuara nga Operatorit Ekonomik "AOME" SH.P.K., Gjeravica, Kolovicë (NUI: 601258785), komisioni për rivlerësim, në mbështetje të procedurës së e-prokurimit dhe pas shqyrtimit të ofertës së paraqitur, ka realizuar një vlerësim të plotë dhe të detajuar të të gjitha elementeve të ofertës, duke përfshirë çmimin e ofruar, sqarimet shtesë të operatorit, si dhe krahasimin me çmimet e operatorëve të tjerë në tregun e Kosovës.

Më datë 21.11.2025, komisioni për rivlerësim ka kërkuar sqarime shtesë nga OE "AOME" SH.P.K., pasi ofertimi i tyre kishte ngritur dyshime për çmim jashtëzakonisht të ulët, në krahasim me çmimet mesatare të tregut për furnizim me lëndë djegëse – dru.

Në vijim, më datë 24.11.2025, komisioni ka dërguar tri kërkesa përmes e-mailit zyrtar tek operatorë të tjerë të njohur në treg, me qëllim krahasimin e çmimeve dhe sigurimin e një baze të besueshme për vlerësim.

Më 25.11.2025, janë pranuar përgjigjet nga operatorët, me çmimet si vijon:

1. Operator 1X – 81.80 €/m³
2. Operator 2X – 84.30 €/m³
3. Operator 3X – 88.95 €/m³

Ndërkaq, OE "AOME" SH.P.K. ka ofertuar çmimin prej 34.90 €/m³ (me TVSH), çmim i cili është vlerësuar jashtëzakonisht i ulët në krahasim me ofertat e tjera dhe trendin e përgjithshëm të tregut. Komisioni ka konsideruar se ky çmim nuk është i qëndrueshëm dhe mund të përbëjë shkelje të parimeve të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Sipas nenit 37 të Ligjit Nr. 04/L-042, autoritetet kontraktuese kanë detyrimin të verifikojnë ofertat me çmime të jashtëzakonshme të ulëta, për të siguruar që ato nuk janë rezultat i praktikave të padrejta, manipulimeve me cilësinë, shmangies së standardeve të punës apo përdorimit të materialeve të papërshtatshme.

Çmimi i ofertuar nga OE "AOME" SH.P.K. ka ngritur dyshime të arsyeshme për çmim anormalisht të ulët në këtë kuadër. Komisioni ka kërkuar nga operatori të japë sqarime bindëse që do të justifikonin çmimin e paraqitur. Megjithatë, pavarësisht kërkesës për sqarime shtesë, OE "AOME" SH.P.K. nuk ka paraqitur argumente të mjaftueshme për të dëshmuar se çmimi i ofertuar është i qëndrueshëm dhe i bazuar në kushtet reale të tregut. Pas shqyrtimit të përgjigjeve të ofruara, komisioni për rivlerësim ka konstatuar se operatori nuk ka arritur të dëshmojë se ka realizuar më parë ndonjë kontratë të vlefshme me sasi dhe çmim të përafërt me ofertën e paraqitur. Për rrjedhojë, oferta është vlerësuar si e papërgjegjshme, pasi çmimi nuk është në përputhje me çmimet e zakonshme të tregut dhe krijon dyshim të fortë për qëllime të papajtueshme me ligjin dhe parimet e prokurimit publik.

Bazuar në deklaratën e ndarjes së mjeteve financiare, Drejtoria Inicuese (hartuesi i specifikacionit teknik) ka vlerësuar një buxhet prej 136,000.00 € për 1,700 m³, që i korrespondon një çmimi të parashikuar prej rreth 80 €/m³. Ndërsa oferta e OE "AOME" SH.P.K. prej 34.90 €/m³ përbën më pak se 50% të çmimit të planifikuar, duke u konsideruar çmim anormalisht i ulët dhe i pajustificueshëm.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net

Në përputhje me rregullat e Ligjit të Prokurimit Publik dhe në funksion të garantimit të transparencës dhe integritetit të procedurës së prokurimit, komisioni për rivlerësim ka konstatuar se oferta e OE "AOME" SH.P.K. është e paqëndrueshme, e papërgjegjshme dhe si e tillë nuk mund të pranohet, për shkak të çmimit jashtëzakonshëm të ulët që nuk është justifikuar në asnjë mënyrë.

Në përfundim, komisioni për rivlerësim, duke marrë parasysh analizën krahasuese të operatorëve të tjerë dhe çmimin e paraqitur nga OE "AOME" SH.P.K., ka vlerësuar se kjo ofertë është në kundërshtim me parimet e prokurimit publik, duke cenuar transparencën, konkurrencën dhe interesin e autoritetit kontraktues.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuara në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që arsyet e evidentuara nga komisioni vlerësues për eliminimin e parashtruesit si të papërgjegjshëm janë të sakta, të matshme dhe të ligjshme. Rrjedhimisht është gjetur se eliminimi i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë.

Vlen të shtohet se oferta e parashtruesit është jo vetëm jonormalisht më e ulët sesa cmimet e tregut por është rreth 40% më e ulët sesa mesatarja e ofertave që kanë marrë pjesë në këtë aktivitet të prokurimit. Në anën tjetër, parashtruesi as përmes sqarimeve shitesë nuk ka arritur që të shpjegojë as ekonominë e procesit, as zgjidhjet teknike të ofruara, as kushtet vecanërisht të favorshme, as origjinalitetin e furnizimeve dhe as elementet e tenderit ku përfshihen elementet e nëntotaleve për paga, kompensimet, materialet, kostot fikse dhe profitet, të cilat janë kriteret sipas nenit 41.8 dhe 41.9 të RRPP. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka ofertuar me çmimet jonormalisht të ulëta dhe ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 30.12.2025


Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.